



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Skrapar, më 08.09.2022

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË NË
SHËRBIMIN CIVIL PËR NIVELIN E MESËM DREJTUES
(DREJTOR DREJTORIE)**

***Lloji i diplomës “Shkenca Teknike ”
niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”***

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kreut II dhe III të Vendimit nr.242 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar Bashkia Berat shpall procedurat e lëvizjes paralele , ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil për pozicionin :

- ***1(një) Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit , Kategoria e pagës II-b.***

Plotësimi i pozicionit më sipër bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele .Pozicioni i lartpërmendur i’u ofrohen fillimisht nëpunësve civil të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.

Vetëm në rast se për këtë pozicion në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele rezulton se vendi është përsëri vakant, pozicioni është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë

Për të dyja procedurat: lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LËVIZJEN PARALELE

DO TË JETË

22.09.2022

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR NGRITJE NË DETYRË DO TË JETË

29.09.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

PËRSHKRIMI I PERGJITHSHËM I PUNËS

-Përfaqëson Drejtorinë në të gjitha marrëdhëniet e saj me sektorët e tjerë të bashkisë, institucionet e ndryshme dhe me gjithë organet shtetërore, vendore e qendrore për problemet që kanë të bëjnë me zhvillimet urbane në qytet.

-Ndjek punën dhe detyrat e ngarkuara brenda drejtorisë dhe në lidhje me problemet e disiplinimit të urbanizimit të qytetit.

-Organizon punën studimore dhe propozon masat konkrete në drejtim të mbarëvajtjes së problemeve të urbanizimit të qytetit dhe të hartimit të instrumentave vendor të planifikimit të territorit.

-Organizon dhe ndjek punën për koordinimin e kërkesave të subjekteve juridike apo fizike me politikat urbane të Bashkisë.

-Informon në mënyrë periodike eprorin direkt për problemet e ndryshme në lidhje me zbatimin e legjislacionit në fushën e planifikimit të territorit.

-Ndjek detyrat e dhëna nga eprori direkt dhe raporton për shkallën e nivelin e realizimit të tyre.

-Kërkon llogari nga vartësit për zbatimin e disiplinës në punë dhe realizimin e detyrave funksionale të tyre.

-Propozon tek eprori direkt ndërhyrjen pranë organeve kompetente për zgjidhjen e problemeve që dalin nga sektorët që mbulon.

-Vlerëson punën vjetore të vartësve dhe i propozon Kryetarit të Bashkisë masa disiplinore për vartësit të demonstrojnë paaftësi në kryerjen e detyrës osë shkelje të disiplinës në punë.

-Studion dhe i'u jep zgjidhje problemeve të infrastrukturës së qytetit ku përfshihen: rrugë, trotuare, rrjeti i kanalizimeve, linjat e elektrike, telefonise etj.

-Koordinon me Drejtorinë e Shërbimeve Publike pranë bashkisë, për projektet që nevojiten për përmirësimin e infrastrukturës dhe investimet e reja publike me financime të brendshme, buxhetore apo të huaja.

-Mer pjesë në projektimin dhe bën preventive të rikonstruksioneve dhe ndërtimeve të reja në infrastrukturën publike të qytetit.

-Kontrollon analizën e çmimeve të preventivave të objekteve publike dhe private të paraqitura për miratim në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

-Ndjek vazhdimisht në terren procesin e zbatimit të projekteve të hartuara, duke sqaruar e iu dhënë zgjidhje problemeve që dalin gjatë realizimit të projektit në bashkëpunim me mbikqyrësat e punimeve

-Kontrollon të gjithë dokumentacionin teknik dhe lidhjen me infrastrukturën inxhinierike ku përfshihen:

a) Kontrollin e planvendosjes së objektit të ndërtuar,

b) Kontrollin e realizimit sipas specifikimeve teknike të çdo objekti,

c) Akt-kontrollin e projektit në terren sipas fazave të realizimit të punimeve (piketim, themele, kuota 0.00, karabina, rifiniturë, sistemim sheshi)

-Bashkërendon punën ndërsektoriale brenda Drejtorisë.

-Kryen kontrollin përfundimtar të objektit në përputhje me dokumentacionin e miratuar dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përgatit materialin përkatës për shqyrtim e miratim.

-Përditëson në mënyrë periodike në hartë dhe rregjistër të gjitha objektet me leje ndërtimi të miratuara.

-Kontrollon dhe është përgjegjës për genplanet e azhornimit të përgatitura nga Specialistët e bashkisë dhe subjektet private.

-Arkivon të gjitha materialet e sistemuara në dosje në momentin kur merren dokumentet nga të interesuarit për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi.

-Nxjerr dhe fotokopjon materialet e dosjeve që kërkohen për konfirmim e vërtetim me origjinalet.

-Llogarit dhe plotëson faturat për kryerjen e pagesave për dokumentet dhe fletët e tjera të projekteve që dalin nga arkivi për qytetaret dhe subjektet të njehsuara me origjinalin.

-Hedh të dhënat e arkivës në database-n përkatëse, me qëllim kompjuterizimin e të dhënave urbanistike.

-Hedh në regjistrin e planifikimit të territorit kërkesat për leje zhvillimi, leje ndërtimi dhe leje përdorimi në mbeshtetje të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe rregulloreve të miratuara për zbatimin e ketij ligji.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

-Shqyrton me përgjegjësi dokumentacionin e nevojshëm teknik dhe juridik të kërkesave të paraqitura për leje zhvillimi, leje ndërtimi dhe leje përdorimi sipas ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe rregulloreve të miratuara për zbatimin e këtij ligji.

-Kontrollon dokumentacionin teknik (projektin e arkitekturës dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm) për të siguruar respektimin e ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe rregulloreve të miratuara për zbatimin e këtij ligji.

-Kontrollon planvendosjen e objektit, distancat nga kufiri i pronës dhe pronat e objekteve kufitare si dhe lidhjen e objektit me rrugën sipas ligjit të planifikimit të territorit.

-Zbardh planvendosjen dhe dokumentacionin që kërkon konfirmim për çdo kërkesë të miratuar me vendim si dhe plotëson të gjithë formularët e nevojshëm që shoqërojnë vendimin pas kryerjes së pagesës nga kërkuesi.

-Kryen inspektimin e situatës në vend për secilin objekt.

-Përgatit të dhëna statistikore lidhur me lejet e miratuara.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori ,Kategoria II-b
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Kandidatët të zotërojnë Diplome Universitare të nivelit / **Master Shkencor** sipas legjislacionit të arsimit të lartë në , **Shkenca Teknike** , si diploma Bachelor edhe ajo master shkencor duhet të jenë në të njëjtën fushë . (*Diplomat të cilat janë marrë*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

- Përvojë pune **5 vite** në administratën shtetërore dhe/ose institucionet e pavarura dhe/ose institucionet e Qeverisjes Vendore
- Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Mbajtësi i këtij pozicioni duhet të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grupe.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrimi plotësuar nëpërputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës dhe listes se notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Aktin e Statusit të Nëpunësit Civil
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore (deshmi penale)
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë në sekretarinë e Bashkisë ose në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Skrapar, brenda dates **22.09.2022**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **24.09.2022** Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Skrapar do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë si edhe në standin e Informimit të Publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit , nëpërmjet email-it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si edhe Aktet nën ligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil
- Njohuritë mbi ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit“
Ligji nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillin e Territorit”, I ndryshuar
- Ligji Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit“ i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet I suksesshëm .

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Skrapar do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë, Agjensinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe në **stendën e informimit të publikut**. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike .Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2

NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- Të jetë nëpunës civil I konfirmuar;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Niveli I diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës përnjehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Kandidatët të zotërojnë Diplome Universitare të nivelit / **Master Shkencor** sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në **Shkenca Teknike.....**, si diploma Bachelor edhe ajo master shkencor duhet të jenë në të njëjtën fushë . *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

- Përvojë pune **5 vite** në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e Qeverisjes Vendore
- Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Mbajtësi i këtij pozicioni duhet të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grupe.

2.2 DOKUMENTECIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- Jetëshkrim I plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- Aktin e Statusit të Nëpunësit Civil
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjëndjes gjyqësore(deshmi penale),
- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- Certifikata për gjuhën e huaj
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postën në sekretarinë e Bashkisë Skrapar ose në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Skrapar Brenda dates **29.09.2022** .





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data 01.10.2022 Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Skrapar do të shpallë në Faqjen Zyrtare, Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe në stendën e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e veçanta dhe kushtet e për ngritje në detyrë për Kategorinë e Mesme Drejtuese, , si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për ngritje në detyrë do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Berat, nëpërmjet email-it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si edhe Aktet nën ligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil
- Njohuritë mbi ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit“
Ligji nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, I ndryshuar
- Ligji Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit“ i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, derinë 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike

Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm .

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Skrapar do të shpallë fituesin në portalin e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftesive, Faqjen Zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

BASHKIA SKRAPAR

